



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2019:254167

Datë: 19.02.2021

Numri i dokumentit: 01524089

**P.nr. 1018/19**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM**, me gjyqtarin Murat Hulaj, me pjesëmarrjen e praktikantit gjyqësor, Luan Mehmetaj, në çështjen penale kundër të pandehurit K. Sh. nga ..... tani me banim në ....., për shkak te veprës penale, **falsifikimi i dokumentit** parashikuar nga neni 390 par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, PP/II.nr.1297/2019 të datës 30.10.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, të dt. 03.02.2021, në prezencë të Prokurorit të shtetit Dorjan Juniku, të pandehurit K. Sh., me datë 03.02.2021 shpalli publikisht, ndërsa me dt.19.02.2021, përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

***I pandehuri,***

**K. SH.**, i lindur me datë ....., në ....., tani me vendbanim në rrugën “.....”, nr. 94, ....., i biri i B. dhe nënës R. e gjinisë S., i martuar, baba i katër fëmijëve me profesion inxhinier i gjeologjisë, punon si tregtar i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës, i pa gjykuar më parë mbrohet në liri.

**ËSHTË FAJTOR**

**Për shkak se:**

Qe nga 23.12.2017 e gjer me dt. 08.05.2019 ora 20:15 ne ....., me dije përdor dokumentin e falsifikuar si origjinal dhe atë targat gjermane me nr. .... ne atë mënyre qe: pasi i pandehuri siguron targat falsifikuara te cekura si me larte te njëjtat me dije i përdor si origjinale duke i vendosur ne veturën ....., ngjyre te ....., viti i prodhimit ....., me numer te shastisë ..... qe ishte veture e paregjistruar dhe ishte i doganuar, ku edhe i konfiskohen nga Policia e Kosovës pas ndalimit te tij,

- me çka ka kryer veprën penale, **“falsifikimi i dokumentit”** nga neni 390 par. 1, te KPRK-se.

Andaj, gjykata konform nenit 7, 38, 43, 59, 92, 390 par.1 të KPRK-së, dhe nenit 365 të KPPRK-së, të pandehurin e:

**G J Y K O N**  
**ME DENIM ME GJOBË**

- I. Dënim me gjobë në shumën prej 600 (gjashtëqind) euro, i cili dënim ka për tu paguar në afatin prej 15 ditësh pasi që aktgjykimi të bëhet i formës së prerë.
- II. Nëse i pandehuri, dënimin me gjobë nuk e paguan në afatin e paraparë prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë se aktgjykimit atëherë dënimi me gjobë do ti zëvendësohet në dënim me burg, duke llogaritur një ditë burgimi shumën prej 20 euro.
- III. **Dënim Plotësues** – në kuptim të nenit 92 të KPRK-së konfiskohen targat me numer LDS-826 C.
- IV. I pandehuri obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 (tridhjetë) euro, në emër të fondit për kompensimit të viktimave të krimit shumën prej 30 (tridhjetë) euro, ndërsa për shpenzimet e procedurës penale gjykata do të vendos me aktvendim të veçantë nëse gjanë shpenzime të tilla.
- V. E të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

**A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Pejë, Departamenti për krime të përgjithshme ka ngrit aktakuzë , PP/II.nr.1297/2019 të datës 30.10.2019 kundër të pandehurit K. Sh. për shkak të veprës penale falsifikim i dokumentit nga neni 390 par. 1 të KPRK-së.

Konform nenit 245 të KPP-së me dt. 03.02.2021, është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar, ku është konstatuar mbajtja e seancës fillestare në të cilën kanë marrë pjesë, prokurori i shtetit Dorjan Juniku i pandehuri K. Sh..

Gjykata konform dispozitave të nenit 246 par. 1, të KPP-së, e ka udhëzuar të pandehurin me të drejtat e tij, ku në këtë rast i pandehuri deklaroi se i ka kuptuar këto të drejta dhe se ka deklaruar se për mbrojtës nuk ka nevojë.

Pas leximit të aktakuzës, nga Prokurori i Shtetit, gjyqtari i vetëm gjykues, pasi që është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, i ka dhënë mundësi të pandehurit që të deklarohet për pranimin ose mospranimin e fajësisë, duke e njoftuar për rëndësinë dhe pasojat e pranimit të fajësisë.

I pandehuri në deklarin e tij para gjykatës ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, ndihet i penduar, ndien keqardhje që ka ndodhur ky rast, i premtion gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprime të tilla apo veprime të tjera që përbëjnë vepër penale.

Gjyqtari i vetëm gjykues, ka marrë mendimin nga Prokurori i Shtetit, ku prokurori i shtetit është pajtuar me pranimin e fajësisë ngaqë ky pranim është bërë konform nenit 248 te KPP-së nga ana e të pandehurit dhe meqenëse te gjitha provat e bashkangjitura të aktakuzës, provojnë se i pandehuri e ka kryer të veprën penale për të cilën akuzohet. Gjykatës i propozon që me rastin e përcaktimit te llojit dhe përkatësisë së dënimit ta merre parasysht si rrethane lehtësuese pranimin e fajësisë.

Gjyqtari i vetëm gjykues, është i bindur, se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë konform dispozitave të nenit 246 dhe 248 par 1 të KPP-së, pasi që i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes dhe provat në të cilat edhe mbështet aktakuza siç janë: Raporti informues me nr. te rastit 2019-HRP-49 i dt. 13.05.2019; Raporti i oficerit Osman G09 # 2748, date 08.05.2019; Raporti i oficerit S. H. # 8975, date 08.05.2019; Urdhër pagesa, NLB banka, dt.21.03.2019; - Procesverbali mbi intervistimin e te dyshuarit dhëne polici me datën 08.05.2019; Procesverbali mbi intervistimin e te dyshuarit dhëne polici me datën 10.05.2019; Dëftesa mbi Konfiskimin e targave, date 08.05.2019; Dëftesa mbi Konfiskimin e veturës, date 08.05.2019; Pesëmbëdhjete (15) foto te veturës, - Kërkesa për sekuestrim te përkohshëm, PPN.II.nr. 429/2019, date 14.05.2019; Urdhër të Gjykata Themelore ne Peje, Nr. UGJK 57/19 për Sekuestrim te Përkohshëm te Sendeve, date 15.05.2019; Procesverbali mbi marrjen ne pyetje te pandehurit K. Sh., date 10.06.2019; Kërkese për lirim te përkohshëm te veturës se sekuestruar përkohësisht, date 11.06.2019; Urdhërese për kthim te veturës se sekuestruar përkohësisht, date 14.06.2019; Autorizim për Grumbullim te Informacionit, date 25.06.2019; Aktvendim për Aprovim te Kërkesës për Lirim te veturës se sekuestruar përkohësisht, Gjykata Themelore ne Peje, UGJK 57/19, date 12.06.2019; Kallëximi Penal, 2019-DA-0849, Sektori Rajonal i Hetimeve, Policia e Kosovës, date 06.06.2019; Email komunikimi, date 30.05.2019; Kërkese për Verifikim, date 12.05.2019; Libreza e qarkullimit, nr.1405921, targat 03-503-GF; ~certifikata mbi konfirmimin e rregullsisë teknike te automjetit, date 09.05.2019; ~certifikata mbi konfirmimin e rregullsisë teknike te automjetit, date 12.04.2019; Deklarate, date 12.04.2019; Dokurmentet e veturës, Golf 7, Sherif COSOVIC, targat LDS 826 Ci Foto krahasuese, tabelat e përkohshme COL dhe tabelat e falsifikuara si te rregullta; Plotësirni i Kallezimit Penal, 2019-DA-0849 (2019-HRP-49); Email komunikimi, date 28.06.2019;

Me faktet e ofruara, si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv te aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit K. Sh. qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale të falsifikim i dokumenteve parashikuar nga neni 390 par. 1 të KPRK-së.

Gjykata nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale ndaj të pandehurit dhe se i njëjti është penalisht përgjegjës. Sa i parket fajësisë i pandehuri ishte i vetëdijshëm për veprat e kryera dhe atë i ka kryer me dashje.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 69 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurin, gjykata mori sjelljen korrekte në gjykatë, pranimin e fajësisë, singëritetin deklarues, pendimin për veprën e kryer dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale, ndërsa rrethana rënduese ndaj të pandehurit gjykata gjeti se i njëjti ka qenë i dënuar sipas aktgjykimit P.nr. 277/18, për një veprë tjetër e cila ishte kryer në vitin 2013 dhe i njëjti ishte shpallur fajtor dhe dënuar më kusht

Sipas bindjes së gjyqtarit, dënimi i shqiptuar, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Gjyqtari i vetëm gjykues, gjithashtu ka konstatuar se me këto dënime mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Gjykata në bazë të nenit 453 të KPRK –ës, e ka obliguar të pandehurin që gjykatës ti paguaj shumë prej 30 euro në emër të paushallit gjyqësor, ndërsa konform nenit 39 par.1, 2, 3, nënpar.3.1, të ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, e obligoi në pagesën e taksë, në shumën prej 30 euro, përderisa për shpenzimet e procedurës penale gjykata do të vendos me aktvendim të veçantë nëse gjen shpenzime të tilla.

Vendimin mbi dënimin plotësues gjykata e mori në përputhje me nenit 92 të KPRK-së, duke marrë qëndrim mbi konfiskimin e targat LDS-826C, e të cilat duhet të asgjësohen pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 365 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenit 370 të KPP-së, gjykata përpiloj këtë aktgjykim.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË**  
**-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM,**  
**P.nr. 1018/19 dt. 19.02.2021**

**Praktikanti gjyqësor**  
Luan Mehmetaj

**GJYQTARI,**  
Dr. Sc. Murat Hulaj

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.